URDHËR
Nr. 363, datë 2.4.2026

PËR SHFUQIZIMIN E URDHRIT NR. 935, DATË 26.9.2025, "PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E NORVEGJISË";

URDHRIT NR. 119, DATË 6.2.2026, "PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E RUMANISË";

URDHRIT NR. 188, DATË 23.2.2026, "PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E SLLOVAKISË"

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në pikën 3, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe në nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e:
- Urdhrit nr. 935, datë 26.9.2025, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Norvegjisë";
- Urdhrit nr. 119, datë 6.2.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Rumanisë";
- Urdhrit nr. 188, datë 23.2.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Sllovakisë".

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri